



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Datë: 18.03.2026, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa në Junik, të mbajtur me datë 18 mars 2026, në orën 10⁰⁰, në sallën e takimeve në objektin e Komunës në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Leonard Lolluni, kryesues (AAK),
2. Bedrush Hoxha, përfaqësues (LDK),
3. Litafile Isufaj, përfaqësues (LDK),
4. Ajshe Gacaferi, përfaqësues (AAK), dhe
5. Jetmir Tofaj, përfaqësues (LVV)

Poashtu, të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i Komunës z.Besart Tofaj, Ud e Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa znj.Ardita Hoxha, Ud i Drejtorit për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim z.Demokrat Ganiaj, Ud i Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Fatos Shala dhe Zyrtari Kryesor Financiar z.Arten Hamza.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z.Leonard Lolluni, i cili ceku se të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi z.Leonard Lolluni, hodhi në diskutim dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, me shtimin e pesë pikave të reja, si në vijim;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së,
2. Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,
3. Shqyrtimi i plotësimit ndryshimeve në rregulloren Komunale për menaxhimin e mbeturinave,
4. Shqyrtimi i raportit të punës të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025,
5. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua me pesë vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së,

Kryesuesi, z. Leonard Llojuni, si pikë të parë të rendit të ditës, paraqiti për shqyrtim dhe miratim procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF-së, duke pyetur nëse ka ndonjë diskutim apo vërejtje nga anëtarët lidhur me këtë çështje.

Meqenëse nuk pati diskutime apo propozime shtesë nga anëtarët, Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë.

Kjo pikë u miratua me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Dytë

2. Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,

Kryesuesi, z. Leonard Llojuni, njoftoi se është pranuar kërkesa nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026, në shumën totale prej 50,419.96 €, prej të cilave 30,419.96 € janë planifikuar për investime kapitale dhe 20,000.00 € për shpenzime komunale. Me këtë rast, ai i dha fjalën për sqarime Zyrtarit Kryesor Financiar, z. Arten Hamza.

Z. Arten Hamza sqaroi se bartja e mjeteve është proces i rregullt vjetor, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040. Ai theksoi se për vitin 2025 ishin planifikuar të hyra vetanake në vlerë prej 204,942.00 €, ndërsa janë inkasuar 166,489.60 €. Së bashku me bartjen nga viti 2024 në vlerë prej 108,484.86 €, totali i të hyrave për vitin 2025 ka qenë 274,974.46 €, prej të cilave janë shpenzuar 224,554.50 €, ndërsa shuma e mbetur për bartje është 50,419.96 €.

Ai propozoi që kjo shumë të bartet në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë prej 30,419.96 €, për projektin “Bashkëfinancimi i projekteve” dhe projektin “Rekonstruimi i rrugës ‘Shkëlzen Gacaferi’ – Faza I”, si obligim i mbetur nga viti 2025, si dhe në kategorinë e shpenzimeve komunale në vlerë prej 20,000.00 €, në kuadër të Programit “Shërbime publike”, nënprogrami “Infrastruktura rrugore”.

Kryesuesi z. Leonard Llojuni e hodhi në diskutim ku nga anëtarët e Kuvendit fjalën e mori z. Jetmir Tofaj dhe kërkoi sqarim lidhur me përfshirjen e projektit “Shkëlzen Gacaferi” në dy kategori, me ç’rast z. Arten Hamza sqaroi se projekti është i ndarë në segmente. Gjithashtu, ai kërkoi informata për shumën e borxhit në kategorinë e shpenzimeve komunale, ku u sqarua se borxhi është rreth 17,000 €, por ka shënuar rritje për shkak të rritjes së çmimeve dhe shtimit të shpenzimeve.

Po ashtu, z. Jetmir Tofaj ngriti çështjen e mundësisë së bartjes së mjeteve për Komitetin për Arsim, Kulturë, Shkencë dhe Sport, ndërsa z. Arten Hamza theksoi se kjo çështje kërkon bazë ligjore, përcaktim të linjave buxhetore dhe vendim të Kuvendit Komunal, sepse sipas ligjit mund të paguhet vetëm dy komunitete si KPF dhe KK.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Arten Hamza, theksoi se komuna është në fazën e nënshkrimit të një projekti të IPA-s, i cili parasheh bashkëfinancim, ku kërkohet edhe pjesëmarrja financiare e komunës.

Kryesuesi gjithashtu përmendi një kërkesë të banorëve të lagjes “Bajraktar” për intervenim në rrugën e kësaj lagjeje, ndërsa z. Arten Hamza sqaroi se kjo çështje mund të shtrohet si pyetje në drejtoritë përkatëse dhe të kalojë në kuvend.

Kjo pikë u miratua me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Tretë

Shqyrtimi i plotësim ndryshimeve në rregulloren Komunale për menaxhimin e mbeturinave,

Kryesuesi, z. Leonard Lolluni, njoftoi se, sipas kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, në shqyrtim është plotësim-ndryshimi i Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave, si pasojë e rritjes së çmimeve. Me këtë rast, ai i dha fjalën U.D. Drejtorit për Shërbime Publike, z. Demokrat Ganiaj.

Z. Demokrat Ganiaj theksoi se ndryshimet lidhen kryesisht me përditësimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave, të përcaktuara në nenin 23 të rregullores aktuale, bazuar në vendimin e Ministrisë së Ekonomisë të vitit 2022. Ai shtoi se, në bashkëpunim me komisionin e themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës, është bërë një analizë dhe është propozuar rritje prej rreth 15% për secilën kategori, si pasojë e rritjes së çmimeve.

Ai sqaroi se tarifat ekzistuese për konsumatorët shtëpiakë janë 6.00 € për banorët rezidentë dhe 2.00 € për jo-rezidentët, ndërsa për konsumatorët komercialë/industrialë variojnë nga 6.00 € deri në 26.00 €, si dhe aplikohen tarifa të veçanta për zbrazjen e kontejnerëve. Sipas propozimit të ri, tarifat rriten në 7.00 € për banorët rezidentë dhe 2.50 € për jo-rezidentët, ndërsa për konsumatorët komercialë/industrialë variojnë nga 7.00 € deri në 29.00 €, si dhe 16.00 € dhe 50.00 € për zbrazjen e kontejnerëve 1.1 m³ dhe 7 m³. Ai kërkoi që kjo çështje të procedohet si pikë e rendit të ditës dhe më pas të kalojë në dëgjim publik, me qëllim të marrjes së komenteve nga qytetarët dhe Kuvendi.

Kryesuesi hapi diskutimin, ku fjalën e mori z. Jetmir Tofaj, i cili pyeti pse Komuna e Junikut nuk ka një ndërmarrje publike për menaxhimin e mbeturinave, edhe pse procedura kishte filluar më herët.

Në përgjigje, z. Demokrat Ganiaj theksoi se ka qenë kryesues i komisionit përkatës, se procesi është zhvilluar me asistencë nga GIZ dhe se është aplikuar në ministri. Ai sqaroi se pas aplikimit të parë, ministria ka ndryshuar formularin, duke kërkuar riaplikim, i cili është bërë. Megjithatë, edhe pse sipas ligjit përgjigja duhet të jepej brenda 60 ditësh nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, deri më tani nuk është pranuar asnjë përgjigje.

Po ashtu, Kryesuesi theksoi se ka pasur kërkesë nga punëtorët e menaxhimit të mbeturinave lidhur me nivelin e pagave të tyre.

U.D. Drejtori për Shërbime Publike, z. Demokrat Ganiaj, sqaroi se, edhe pse bëhet fjalë për punëtorë të një kompanie private, pagat e tyre janë të kënaqshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë edhe rritjen sipas pagës minimale. Ai shtoi se pagat realizohen përmes bankës, njësoj si në institucionet publike, dhe se punëtorët nuk kanë obligime shtesë apo tarifa për pagesë.

Kryesuesi e hodhi në votim ku edhe kjo pikë kaloi me 5 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Katërt
Shqyrtimi i raportit të punës të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025,

Kryesuesi, z. Leonard Lolluni, theksoi se raporti është përgatitur nga vetë ai, në bazë të të dhënave të gjetura në kompjuterin e ish-kryesuesit. Ai sqaroi se raporti është kërkuar nga Zyra e Kryetarit, si dhe nga MAPL, për qëllime të monitorimit të mbledhjeve dhe vlerësimit të performancës së komunës.

Gjatë diskutimit, Kryesuesi theksoi se gjatë vitit raportues janë mbajtur më pak mbledhje, si pasojë e vitit zgjedhor, krahasuar me vitet e tjera.

Anëtari i Kuvendit, z. Jetmir Tofaj, vuri në dukje se, sipas legjislacionit raporti duhej të përgatitej nga ish-kryesuesi. Ndërkohë, anëtarët e tjerë theksuan se kjo nuk paraqet neglizhencë, pasi raporti përgatitet pas përfundimit të vitit.

Kryesuesi e hodhi në votim shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025, i cili u miratua me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Para kalimit në pikën e radhës, Kryesuesi njoftoi se ka pranuar një kërkesë nga U.D. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqënies sociale për iniciimin e Planit për Strehim Social, si dhe një kërkesë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim për iniciimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale, ku të dy palët kerkuan iniciimin e procedurave për hartimin e këtyre planeve.

Po ashtu, u kërkuar edhe themelimi i Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi. Kryesuesi theksoi se në javët në vijim do të mbahet mbledhja e Komitetit për Komunitete dhe pas saj, kjo çështje do të trajtohet në përputhje me procedurat përkatëse.

Pika e pestë
Të ndryshme

Kryesuesi fjalën e kaloi tek anëtarët e KPF-së nëse kanë pyetje ose kërkesë për të prarashtruar.

Fjalën e kaloi tek z.Bedrush Hoxha, i cili pyeti U.D. Drejtori për Shërbime Publike, z. Demokrat Ganiaj , lidhur me një shqetësim të një qytetari tek rruga Lush Musa, kishin probleme me rrymë, pyeti se a është e mundur të bëhet një zgjidhje.

Z. Demokrat Ganiaj sqaroi se ndërprerja është bërë për shkak të paraqitjes së një mase të tepruar, pasi ndriçimi publik ka qenë i ndezur gjatë ditës dhe natës që shkakton shpenzim të kotë. Ai theksoi se një pjesë e ndriçimit publik është e lidhur me një fije kabull ose dy fije dhe menaxhohet nga KEDS-i, i cili vendos kufizime që dritat të jenë të ndezura vazhdimisht. Për shkak të kostos së lartë, komuna ka mundësi të kufizuara për ndërhyrje në këtë drejtim. Për këtë shkak është kufizuar ndriçimi aty.

Kryesuesi, z. Leonard Lolluni, paraqiti një kërkesë të një banori nga rruga për Voksh, lidhur me prerjen e asfaltit dhe krijimin e një grope në atë zonë. U.D. Drejtori, z. Demokrat Ganiaj, sqaroi se duhet pritur që toka të stabilizohet dhe të krijohen kushtet e nevojshme para se të ndërhyhet.

Po ashtu, Kryesuesi kërkoi informacion lidhur me një tabelë rrugore që është larguar, duke kërkuar sqarim nëse largimi është bërë me qëllim apo për shkak të ndonjë problemi.

U.D. Drejtori, z. Demokrat Ganiaj, theksoi se tabela në fjalë është vendosur dhe më pas larguar, dhe se duhet të evidentohet nëse largimi është bërë nga banorët apo si pasojë e qarkullimit të mjeteve, përfshirë edhe kamionët. Ai shtoi se ka raste kur banorët nuk pajtohen me emërtimin e rrugëve. Po ashtu, ai theksoi se këtë vit është paraparë sinjalizimi i rrugëve, ku në kuadër të këtij procesi planifikohet edhe riparimi i tabelave ekzistuese

Anëtarja, znj. Litafete Isufaj, theksoi se nga ura e Erenikut deri te rruga “Nora Kelmendi”, pas përfundimit të punimeve të kanalizimit dhe ri-asfaltimit, rruga ka filluar të dëmtohet, veçanërisht deri te kthesa për në Moronicë. Ajo kërkoi që kjo çështje të evidentohet, pasi në atë zonë ka një përroskë që shkakton rrjedhje uji dhe dëmton asfaltin, duke kërkuar që të ndërhyhet sa më parë. Po ashtu, ajo kërkoi edhe largimin e pengesave në rrugën për në Moronicë.

U.D. Drejtori, z. Demokrat Ganiaj, sqaroi se ka qenë i pranishëm gjatë një rasti të tillë dhe se dëmtimi është shkaktuar pasi, gjatë izolimit të një shtëpie në afërsi, mbetjet kanë depërtuar në kanal dhe kanë shkaktuar bllokim.

Anëtari, z. Jetmir Tofaj, parashtoi kërkesë lidhur me rrugën “Jahrua”, ku banorët po përballen me probleme me furnizimin me energji elektrike, duke kërkuar që të ushtrohet presion ndaj KEDS-it për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

U.D. Drejtori, z. Demokrat Ganiaj, theksoi se janë adresuar kërkesa të shumta në KEDS, si nga komuna ashtu edhe nga qytetarët, lidhur me këtë problematikë. Ai shtoi se, përveç tensionit të ulët, janë evidentuar edhe dëmtime në shtylla dhe në rrjetin elektrik në atë zonë. Ndërtimi i rrjetit të ri kërkon miratim nga niveli qendror, ndërsa në përgjithësi vërehet neglizhencë nga ana e KEDS-it, pavarësisht kërkesave të dërguara në pika të ndryshme të institucionit.

Anëtari, z. Bedrush Hoxha, kërkoi sqarime lidhur me tensionin e lartë në rrugën Junik–Restelicë.

U.D. Drejtori, z. Demokrat Ganiaj, theksoi se KEDS ka ofruar zgjidhje teknike në bazë të projektit, ku është realizuar edhe vendosja e pusetave. Ai shtoi se, pas përfundimit të këtij investimi, është mbajtur edhe një takim i ri, ku KEDS ka kërkuar bashkëfinancim për realizimin e mëtejshëm të projektit.

Me kaq, kryesuesi z. Leonard Lolluni e shpalli të mbyllur mbledhjen e parë të KPF-së.